



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit nëpërmjet shitblerjes së aksioneve prej 88.89% të Societe Generale Albania SHA nga Societe Generale tek OTP Bank Nyrt.

Përfaqësuesi ligjor i palës njoftuese me shkresën Nr.485 Prot., datë 31.08.2018 “Njoftim përqendrimi në lidhje me shitjen e aksioneve përkatëse shoqërisë OTP Bank Nyrt nga Societe Generale” ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës dokumentacionin përkatës nëpërmjet të cilit OTP ka përftuar kontrollin e drejtpërdrejtë nëpërmjet blerjes së aksioneve të Banka Societe Generale Albania SHA.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

Blerësi: **OTP Bank Nyrt**¹ është shoqëri aksionare hungareze. Aktivitetet e OTP janë ndërmjetësim monetar si dhe qira financiare, aktivitetet të tjera të shërbimeve financiare, përveç fondit të sigurimeve dhe pensione; brokerimi i kontratave të letrave me vlerë; aktivitete të tjera ndihmëse të shërbimeve financiare, përveç fondit të sigurimeve dhe pensionit; aktiviteti i agjentëve dhe brokerave të sigurimit; aktiviteti i menaxhimit të fondeve; aktiviteti i kontabilitetit; llogari-mbajtjes dhe auditimit, konsulencës fiskale; qiradhënia dhe operimi i pasurive të paluajtshme në pronësi ose me qera.

Shqipëri: OTP nuk ka prezencë në Shqipëri. Asnjë nga aktivitetet e mësipërme nuk ushtrohen nga OTP në Shqipëri.

Shitësi: **Societe Generale** është shoqëri anonime franceze. Societe Generale është një nga organizatat më të mëdha për ofrimin e shërbimeve financiare në Evropë. Aktivitetet e saj përfshijnë shërbime bankare për konsumatorët, kredi për shtëpi, kredi personale, depozita personale; shërbime bankare për korporatat dhe investime, kredi, depozita, llogari bankare për entitete juridike; shërbime financiare; shërbime bankare private; menaxhimi i aseteve; shërbime me letrat me vlerë etj.

Shqipëri: Filiali i kësaj shoqërie në Shqipëri është Banka Societe Generale Albania SHA.

Shoqëria target: **Banka Societe Generale Albania SHA**, shoqëri aksionare e krijuar dhe që ekziston sipas legjislacionit në Shqipëri. Kjo shoqëri ushtron aktivitetin e saj në sektorin financiar dhe bankar në Shqipëri.

¹ Burimi: Statuti i shoqërisë

Aktiviteti i shoqërisë në Shqipëri ushtrohet nëpërmjet marrjes së depozitave monetare ose e fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe dhënia e kredive ose depozitimi për llogarinë e vet; huadhënia e të gjitha llojeve përfshirë ndër të tjera kredinë hipotekore dhe kredinë konsumatorë; qiraja konsumatorë; qiraja financiare; të gjitha pagesat dhe shërbimet e transferimit të parave; garanci dhe letër krediti etj.

OTP Bank Nyrë synon të blejë 88.89 % të aksioneve me të drejtë vote të Banka Societe Generale Albania Sh.a. Përqendrimi i propozuar ka të bëjë me përfitimin e drejtpërdrejtë të kontrollit influencës të Societe Generale Albania.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.